

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission d'Administration Intérimaire des
Nations Unies au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

T R A N S K R I P T

NGA SEANCA SOLEMNE E KUVENDIT TË KOSOVËS E
MBAJTUR MË 5 SHTATOR 2005 ME RASTIN E 95
VJETORIT TË LINDJES SË NËNËS TEREZE

SA SVEČANE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA,
ODRŽANE 05.09. 2005. GODINE POVODOM 95 GODIŠNJICE
RODJENJA MAJKE TEREZE

SHTATOR – SEPTEMBAR
2005

TRANSKRIPT

NGA SEANCA SOLEMNE E KUVENDIT TË KOSOVËS E MBAJTUR MË 5 SHTATOR 2005 ME RASTIN E 95 VJETORIT TË LINDJES SË NËNËS TEREZE

Seanca solemne u mbajt në Sallën e Kuvendit dhe filloi në orën 10,00.
Seancën solemne e kryesoi Akademik Nexhat Daci, Kryetar i Kuvendit të Kosovës.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Mirëseardhje në Seancën solemne të Parlamentit tonë.
Nderime të veçanta sot i shkojnë edhepse në mungesë fizike Presidentit të Kosovës doktor Ibrahim Rugovës duke i dëshiruar mirëseardhje gjithmonë në Parlament;
Mirëseardhje zoti Petersen, Përfaqësues Special i Sekretarit Gjeneral të KB në Kosovë;
Mirëseardhje Kryeministrit dhe Qeverisë së Kosovës, zotit Bajram Kosumi dhe ministrave të pranishëm;
Mirëseardhje Gjeneral Valoto. Është kënaqësi e veçantë që jeni sot në mesin tonë;
I nderuar Kryetar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës Akademik Rexhep Ismajli;
Të nderuar anëtarë të Kryesisë së ASHAK që sot jeni me ne;
I nderuari I peshkv i Kosovës imzot Mark Sopi;
Të nderuar përfaqësues të zyrave diplomatike;
Mysafirë të dashur – mirë se keni ardhur në Seancën solemne.

Të nderuar kolege e kolegë deputetë të Kuvendit të Kosovës,
Puna dhe vepra e Gongje Bojaxhiu – Nënës Tereze është një punë e njeriut të thjeshtë, një punë e zakonshme, një angazhim që buron thellë nga vetë natyra njerëzore për të ndihmuar njerëzit e tjerë në gjithë atë që kanë nevojë.

Kjo nuk është punë për lavdim, është obligim i secilit prej nesh, kudo që jemi dhe kudo që gjendemi. Është një parim që lind me vetë njeriun që t'i gjendesh tjetrit në ndihmë e përkrahje ashtu si vetes, që te të gjithë njerëzit tjerë të shohësh të afërmit, të shohësh motrën, vëllaun, prindin, të shohësh pjesën e vetëvetes si qenie e krijesë të arsyeshme për të pas mision human dhe civilizues në këtë botë.

Deputetë të nderuar,
Ajo që Nënën Tereze e veçon në veprimtarinë e saj është se ndihma dhe angazhimi i saj ishte i përhershëm dhe i pakursyer deri në sakrificë, që – duke u nisur nga parimet kristiane të mëshirës, të solidaritetit dhe të ndihmës ndërmjet njerëzve, që janë parime edhe të të gjitha besimeve tjera e që gjithashtu janë edhe parime bazë të civilizimit të sotëm – ajo shtriu dashurinë te të gjithë njerëzit, rriti shpresën dhe theu të gjitha barrierat e kufizimet duke krijuar një institucion bëmires joprofitabil dhe duke ofruar ndihmën për të gjithë njerëzit pa dallim, jashtë çfarëdo kushtëzimi dhe jashtë çfarëdo propagande.

Shembulli i Nënës Tereze u bë shumë shpejt i njohur si një simbol i dashurisë ndaj njeriut, si një shkëndi e rrezatimit – e drejtuar kah të pashpresët, si një gjetje e perëndisë në zemrën e njeriut, si një humanizim i solidaritetit, i ndihmës dhe i përkujdesjes, si një forcim i besimit se nuk ka çështje që nuk mund të zgjidhet, nuk ka vështirësi që nuk mund të kapërcehet, nuk ka punë që nuk mund të kryhet.

Deputetë të nderuar,

Gongje Bojaxhiu – Nëna Tereze – në rrugëtimin e saj u ngrit në simbol të bëmirësisë dhe përkushtimit në gjithë botën. U ngrit mbi veprën e saj, që çdoherë prekej e shihej nga shumë njerëz duke u shtrirë si forcë kapluese të mbarë njerëzimi, duke u bërë shembull për veprime të ngjashme, duke rritur dashurinë e solidaritetin ndërmjet njerëzve.

Nëna Tereze, si vlerësim të punës së saj mori çmimin Nobël dhe ishte anëtare nderi e shumë akademive dhe institucioneve prestigjioze të botës.

Në gjithë misionin e saj, Nëna Tereze nuk e la pa e përçuar edhe edukatën dhe traditën e përkushtimit dhe të mikpritjes të trevave tona, të popullit shqiptar që i takonte, të vendit të vogël i cili më vonë - në fund të shekullit të njëzet - u bë shembull i intervenimit të suksesshëm dhe i unifikimit të të gjithë botës si rast i parë në histori në mbrojtje të popullsisë së Kosovës nga gjenocidi dhe nga shpërngulja e dhunshme prej trojeve të veta stërgjyshore.

Të nderuar deputetë,

Nderimi i Nënës Tereze në këtë kuvendim të popullit të Kosovës, është nderim i vetë Kuvendit, është nderim i vetë neve që e përkujtojmë sot e do ta përkujtojmë gjithmonë këtë bijë tonën dhe të civilizimit, duke ia vënë emrin e saj rrugëve, shesheve, shkollave dhe institucioneve të tjera, duke nderuar kështu veprën e saj – e cila është kthim kah njeriu dhe njerëzorja, është kthim në cilësitë dhe vetitë më të mira si individ, si popull dhe si civilizim. Ju faleminderit.

Më lejoni tani që të ftoj në foltore, me kënaqësi të veçantë, biografën dhe rrugëtarin më të spikatur të veprës madhore të Nënës Tereze Dom Lush Gjergji. Foltorja është për ju, zotëri.

DOM LUSH GJERGJI:

I nderuari zotri Kryeparlamentar Akademik Nexhat Daci;

I nderuari Kryeadministrator;

Të nderuar deputetë të Parlamentit të Kosovës;

Përfaqësues të zyreve të ndryshme ndërkombëtare dhe zotëri, miq e dashamirë,

Kam nderin dhe kënaqësinë, që së bashku me ju, ta përkujtojmë dhe nderojmë të lumen Nënen Tereze me këtë mbledhje kremtoje të Parlamentit tonë në festën e saj.

Shekujt e përgatitën dhe e dhuruan, ne e përjetuam dhe e trashëguam. Vetëm në prizmin e historisë sonë kombëtare dhe fetare mund ta zbërthejmë, kuptojmë dhe shpjegojmë fenomenin e mirësisë dhe të dashurisë Nënen tonë Tereze. Atë e lindi dhe rriti lashtësia jonë iliro-shqiptare. E qiti në dritë martirizimi ynë shumëshekullor, e edukoi dhe frymëzoi krishtërimi ynë dymijëvjeçar, e lartësoi përvujtëria, e bëri të madhe dhe të pavdekshme dashuria. Bija, motra dhe nëna jonë kështu u bë dhe do të mbesë nëna e të gjithëve. Kjo është vërtetë mrekulli, histori që s'është parë apo dëgjuar kurrë, risi që befasoi dhe përfitoi mbarë njerëzimin, të varfërit dhe të pasurit, të mëdhenjtë dhe të vegjlit, të lirët dhe të robëruarit, të ngopurit dhe të uriturit, të shëndoshët dhe të sëmurët, të privilegjuarit dhe të përjashtuarit, besimtarët dhe jobesimtarët. Kjo histori dhe gjeografi pati shtrirje rruzullore dhe tejkaloi çdo

kufi kombëtar, fetar, gjinor, rasor dhe kastor, duke i dhënë jetës një kuptim, shije dhe domethënie të re, sidomos vuajtjes, pësimit, varfërisë, gërbulës, sidës – me një fjalë të gjitha të ligave të cilat kërcënojnë dhe rrezikojnë njerëzimin. Kështu, një personalitet i vogël Gongje Bojaxhiu, bëri vepra të mëdha, do të thoja hyjnore, gjithnjë e përkrahur me fuqinë e fesë dhe me frymëzimin e dashurisë.

Nëna e jonë Tereze është e madhe, e jashtëzakonshme, e papërsëritshme, e dalluar dhe e shenjtëruar sepse mrekullisht dhe bindshëm mishëroi dhe dëshmoi historinë, traditën dhe kulturën tonë në jetë me pak fjalë por me shumë veprime, herë-herë të rëndomta e herë-herë të jashtëzakonshme por gjithnjë me dashuri dhe për dashuri, me largpamësi, me mendjehollësi, sidomos me mend dhe me zemër flijuese dhe dhuruese.

Kush ishte pra Gongje Bojaxhiu – më vonë Nëna jonë Tereze? Ajo ishte dhe mbeti, së pari – bija e popullit shqiptar dhe e kishës në popullin shqiptar, bija e famullisë së zemrës së krishtit në Shkup, dhe së fundi bija sugare e Kolë dhe Dranë Bojaxhiu. Atë e edukoi për jetë dhe për veprim rrethi familjar, tradita jonë shumëshekullore, famullia ndër të cilët ishin edhe disa personalitete të shquara si për shembull Imzot Lazër Mjeda, Dom Zef Franaj, At Gasper Zadrima, Imzot Franjo Grindovec, At Jan Rinkoviç dhe shumë të tjerë. Ëndrra e saj rinore që të bëhej poete, këngëtare, aktore, valltare, mësuese – më vonë motër misionare – u zbatua në tërësi dhe përpikëri, së pari në Kalkutë e pastaj në Bengali dhe dikur më vonë në meridianet e botës së mjeruar. Për afër 20 vite ishte profesoreshë dhe drejtoreshë e shumë shkollave të mesme në Kalkutë dhe rrethinë. Të tjerët, të gjithë e nderonin dhe admironin për punën e saj të palodhshme por ajo nuk ndalej dhe nuk kënaqej me kaq. Për ta ndihmuar popullatën e Kalkutës, të Indisë, të botës mbarë ajo sdeshi petkun e rregulltarisë së motrave të Loretos, bëri hapin e dytë apo thirrje në thirrje duke u flijuar dhe dhuruar plotësisht dhe vazhdimisht për t'u bërë misionare, mësuese e mbi të gjitha nënë e botës mbarë.

Në vitin 1950 themeloi Rregullin e misionareve të dashurisë për t'i shërbyer të varfërit ndër më të varfër. Në vitin 1960 themeloi Vëllezërit misionarët e dashurisë, ndërsa në vitin 1969 Bashkëpunëtorët e Nënës Tereze Organizatë kjo laike apo shekullore pa dallim feje, kombi, race, kulture e gjinie – me një qëllim të vetëm t'i gjejmë dhe ndihmojmë të varfërit sipas shembullit të Nënës Tereze. Kjo Organizatë është e vetmja në botë që ka një karakter të tillë. Në vitin 1976 ka themeluar Misionarët e dashurisë – Degën kontenplative për t'iu kushtuar uratës dhe jetës shpirtërore dhe së fundi në vitin 1977 themeloi Vëllezërit e fjalës – priftërinjtë për ungjillëzimin e të varfërve ndër më të varfërit, sepse thoshte ata nuk kanë nevojë vetëm për ndihmë, për ushqim, për veshmbathje dhe për mjekim por mbi të gjitha kanë nevojë për praninë dhe dashuri. Mbesin këto pesë degë që i themeloi ajo, mbetet kjo histori, mbetet kjo traditë dhe kulturë, mbi të gjitha mbesim ne. Shembulli, guximi, heroizmi, dashuria e cila doli në luftim kundër të gjitha të ligave dëshmoi edhe një herë çka mund të bëjë njeriu që beson dhe dashuron. Së fundi, mbesim ne populli shqiptar i Nënës Tereze, dëshmitarë të gjallë të mrekullive, të flijimit dhe të vëllazërisë, vazhdimësia dhe trashëgimia e madhe për histori dhe për ardhmëri.

Nëna jonë Tereze e mposhti indiferentizmin, egoizmin, egocentrizmin, ideologjinë konsumiste dhe hedoniste dhe dëshmoi edhe një herë se njeriu – me ndihmën e zotit – gati gati është i gjithpushtetshëm. Ajo e mposhti të keqen, sepse kërkonte vullnetin e zotit, zotin nëpërmes njeriut dhe njeriun nëpërmes zotit dhe nuk i ndau kurrë këto dy të vërteta të mëdha: zoti dhe njeriu nuk janë në antagonizëm apo në luftim, por janë në solidaritet dhe bashkëpunim.

Mësimi, udhëzimi, frymëzimi dhe qortimi i mbarë botës dhe yni është pikërisht që ta gjejmë rrugën, të jemi vetvetja por t'ua mundësojmë edhe të tjerëve që të jenë vetvetja.

Nëna Tereze, me zotin dashuri, dhe me vëllain njeri, duhet të jetë udhërrëfyese dhe strategji për përballimin dhe zgjidhjen e shumë çështjeve ende të hapura dhe të pazgjidhura ndër ne dhe në botë. Risia e vjetër dhe gjithmonë e re është dashuria, si e vetmja fuqi dhe mundësi për ta ndërruar dhe përmirësuar së pari vetveten pastaj familjen, shoqërinë, botën mbarë.

Edhe pse gjithnjë ishte në luftë kundër të ligave dhe të robërive të mbarë njerëzimit, Nëna jonë Tereze nuk e ka harruar kurrë popullin shqiptar. Gjeti kohë dhe mirësi për ta vizituar Kosovën tonë pesë herë. Por, fatkeqësisht ne atëherë ishim në valë të tjera dhe s’kishim kohë për të. Dhe jo vetëm kaq. Ajo gjithnjë është lutur dhe ka ndërmjetësuar te zoti por edhe te qarqet më të larta kishtarë dhe botërore për çështjen e Kosovës, si dhe për paqen në botën mbarë. Pa Nënë Tereze s’mund të kuptohet dhe të shpjegohet angazhimi i madh për Kosovën i Papës Gjon Palit të Dytë, i Sekretarit të Kombeve të Bashkuara Kofi Anan, i ish Kryetarit të SHBA Bill Clinton dhe i shumë të tjerëve, si dhe ndërhyrja e NATO-s në Kosovë në vitin 1999. Roli i saj ishte kulmor dhe vendimtar për ne, për institucionalizimin e çështjes sonë, për shpëtimin dhe lirinë tonë. Kjo më së miri u dëshmuar edhe në vdekjen dhe varrimin e Papës Gjon Palit të Dytë, mikut të madh të popullit shqiptar dhe të mbarë njerëzimit.

Me Nënë Tereze ne i përballuam vitet më të vështira të fundshekullit të njëzet, duke krijuar kështu rrjetin e bëmirisë dhe të vëllazërisë, të bujarisë dhe të qëndresës gandiane, të them edhe më mirë tereziane duke flakur gjakmarrjen apo hakmarrjen, duke ndarë edhe kafshatën e gojës me njëri-tjetrin me përbetim tashmë të njohur: as të fikur as të koritur, duke krijuar sistemin shkollor dhe shëndetësor – paralel. Kështu e dëgjuam dhe zbatuam porosinë e saj më të madhe – jepe pjesën më të mirë të vetvetes.

Ku mori Nëna Tereze gjithë këtë frymëzim, fuqi dhe vizion? Prej zotit dhe prej traditës sonë mijëvjeçare krishtero-shqiptare. Pra, prej përvojës së saj personale, familjare, kombëtare dhe ndërkombëtare. Nëna Tereze, ambasadorja jonë me dimensione botërore, letërnjoftimi dhe pasaporti ynë më i mirë – bëri që ne si popull të arrijmë në pedestalin e nobelizimit për paqë në vitin 1979; të lumturimit në vitin 2003 dhe së shpejti – shpresojmë dhe urojmë – edhe të shenjtërimin.

Tani shtrohet pyetja për mbarë botën, sidomos për botën shqiptare: sa ne vërtetë atë e kemi kuptuar, pranuar, mishëruar dhe sa jemi të gatshëm ta kthejmë atë në gjirin tonë nga edhe doli? S’është në shqyrtim vetëm kthimi i eshtrave e trupit, ngritja e shtatorëve apo e përmendoreve, emërtimi i rrugëve, spitaleve dhe institucioneve tjera, ndërtimi i kishave apo katedrales, por jetësimi i porosive të saj për ne dhe për mbarë njerëzimin.

Nëse ajo disi e ka bashkuar botën mbarë, e kjo është mrekullia më e madhe që bëri ajo, apo zoti përmes saj, vallë a mos ta bashkojë botën e vogël shqiptare. T’i flakim të këqijat e vjetra dhe të reja, të begatohemi me vlera dhe virtyte, gjithnjë të udhëhequr nga e vërteta dhe dashuria sepse vetëm kështu do t’i krijojmë parakushtet për kulturën e jetës dhe qytetërimin e dashurisë.

Pakditë para se të kalonte në amshim, e lumja Nëna Tereze shkroi një poezi me titullin “Dua të kthehem në Shqipëri”, ku ndër të tjera shkruan: “Dua të kthehem në Shqipëri t’u shërbej më të varfërve të gjakut tim dhe me nderim të kujtimit të prindërve dua të kthehem, pranë tyre të mbyllë sytë. Ta dimë, secili prej nesh është i krijuar për të bërë vepra të mëdha me dashuri dhe për dashuri. Kalkutë, 27 gusht 1997”. Edhe ne të gjithë t’i kthehemi vetvetes dhe t’i kthehemi të vërtetës. Kështu më së miri dhe bindshëm do t’i tregojmë vetes dhe botës se Nëna Tereze ishte, është dhe mbetet nëna jonë dhe nënë e mbarë njerëzimit dhe se ne jemi dhe do të

mbesim bijtë e bijat e saj shpirtërore, vërtetë legjendare. Ky do të ishte nderimi më i mirë dhe më i madh për botën mbarë.

Kur e mori shpërblimin Nobel, me 10 dhjetor të vitit 1979, ajo pat thënë: “Shpërblimi më i bukur do të ishte që bota të jetojë në paqe dhe dashuri”. Duke parafrazuar këtë, do të thoja edhe unë: shpërblimi dhe nderimi më i madh do të ishte që ne të jetojmë në paqe dhe në dashuri. Nëse e duam dhe nderojmë Nënë Tereze, e kjo dëshmohet në çdo hap, edhe me këtë seancë kremtoare, atëherë shembullit të saj të shkojmë dhe atë në jetë dhe në veprim sa më mirë ta emitojmë. E lumja Nëna jonë Tereze le të lutet dhe le të ndërmjetësojë para zotit për ne dhe për botën mbarë. Faleminderit.

(Duartrokitje)

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI:

Ndonjëherë, kur njeriun e kaplojnë emocione bën gabime ndoshta të pafalshme. Mirëseardhje përfaqësuesve të Universitetit, në krye me Kryetarin të them profesor Jahja Hoxha. Nuk është disrespekt imi, por mungesë e shënimit që kam pas për të pranishmit, prandaj edhe një herë kërkoj falje.

Tani, është kënaqësi e veçantë që e nderon Parlamentin, se fjalën do ta ketë Kryetari i Akademisë Akademik Rexhep Ismajli. Foltorja është e lirë për ju zoti Kryetar.

AKADEMIK REXHEP ISMAJLI:

I nderuar Kryetar i Kuvendit të Kosovës, Akademik Daci, i nderuar Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara zoti Petersen, i nderuar zoti Kryeministër, të nderuar zotërinj ministra, të nderuar shkelqësia juaj ipeshkv dhe deputetë,

Pas fjalëve të njërit nga biografët më të shquar të Nënës Tereze ndoshta është krejtësisht e natyrshme që ne të tjerët të vijmë deri te përsëritja e gjërave. Megjithatë, unë jam i nderuar që me këtë rast kam mundësi të shpreh disa fjalë për figurën e madhe të Nënë Terezes.

E lindur Gongje Bojaxhiu – Nënë Tereze, humaniste e madhe e shekullit të njëzet, të kontrasteve të përparimit të madh dhe të brutaliteteve po ashtu, personalitet krejtësisht i veçantë me të bëmurit e saj mori mirënjohjet më të mëdha të të gjithë njerëzimit që nga India deri te Shtetet e Bashkuara të Amerikës, që nga Kuba e deri në Shqipëri. Humanizmi i saj në vepër konkret dhe në mbrojtje të dinjitetit njerëzor, në mbrojtje të jetës, u vlerësua lartë dhe me çmimin Nobel për paqe më 1979. Frytet e veprimtarisë së saj të palodhshme, janë shumë të rëndësishme dhe të lidhura me zhvillimet në botën tonë.

Më lejoni që me këtë rast dhe në këtë vend të kujtoj fjalët e dy personaliteteve të botës për të. Kampioni i luftës paqësore nga Afrika e Jugut Nelson Mandela vdekjen e saj e konsideronte “...një humbje për tërë njerëzimin. Do t’na mungojë në përpjekje për të ndërtuar paqen ndërkombëtare dhe rendin e drejtësisë dhe të barazisë”. Po në këtë frymë, e prezentonte para pjesëmarrësve të Konferencës së Kombeve të Bashkuara – Sekretari i atëhershëm Perez de Kuelar. Ajo gjithkund është pritur me mirëkuptim. Ajo është vetë Kombet e Bashkuara, ajo është paqe në botë. Kjo prijëse e madhe shpirtërore, siç është shkruajtur, luftëtare e madhe për më të dobëtit ndër të dobëtit, për më të varfrit ndër të varfrit, duke shkuar midis tyre dhe duke u identifikuar me ta në vuajtje, në veprimtarinë e saj Nënë Tereze prihej nga ideja e formuluar afërsisht kështu prej saj: ruaje kënaqësinë e të dashurit për të varfrin dhe ndaje kënaqësinë me të gjithë ata që takon. Mbaje mend, vepra për dashuri është vepër paqe. Nënë Tereze, për të

gjallit e saj dhe më vonë u cilësua luftëtare e madhe e stolisur me tiparet e bashkëdhembjes, të besimit, të dashurisë, të vetëbesimit, të persistencës, të guximit. U shërbeu njerëzve duke përhapur idenë e dinjitetit të tyre, idenë e respektit për veten dhe për ta, iu afrua atyre që i kishte mundur jeta, luftoi kundër përjashtimit, kundër veçimit të njerëzve. Humanizmi i saj ishte konkret dhe dëshmohej në jetë dhe në angazhimin jetësor e frymëgjatë. Humanizmi i saj ishte i frymëzuar nga besimi i saj në krishtin, por në veprimet konkrete ajo manifestohej midis njerëzve të besimeve të ndryshme, ajo bashkohej dhe gjeneronte idenë e tolerancës ndërnjerëzore, ndërfetare e tjera. Humanizmi i saj fillonte me të dëgjuarit dhe të kuptuarit të tjetrit, për të vazhduar me solidaritetin dhe ndihmën, mbi të gjitha me tolerancën. Ide të ngjashme, tashmë të bëra të përgjithshme, më tingëllonin të afërta edhe në një burim tjetër të shprehur në ndërrim të shekujve në Kartën për tolerancën të Akademisë Evropiane të Shkencave dhe të Arteve. Po citoj: “Toleranca kërkon aftësinë e personit për të kuptuar të tjerët dhe për të respektuar sjelljen e ndryshme. Toleranca shërben si mbrojtës i dinjitetit dhe i lirisë së çdo qenie njerëzore brenda rrethit kulturor të tij apo të saj”.

Nënë Tereza - Gongje Bojaxhiu është cituar të ketë thënë për vete “Me gjak jam shqiptare, me shtetësi Indase, me besim katolike, me vokacion i përkas botës, me zemër i përkas tërësisht zemrës së Jezuit”. E lindur në Shkup më 1910 në një familje shqiptare nga Prizreni, e rritur në ato mjedise dhe me atë mendjesi, Gongje Bojaxhiu qe brumosur me shumë nga vlerat që në zhvillimet e saj të mëtejme në rrugët e formimit dhe të veprimtarisë rruzullore do të bëhen tipare të personalitetit e pse jo edhe të mënyrës së realizimit të çështjeve të ndjekura duke tejçuar vlerat e mjedisit të saj nëpër gjithë botën. Vlerat si toleranca njerëzore, fetare, etnike e tjera, që lidhen me dashurinë për njeriun dhe zotin, burimet apo rezonancat mund t’i kenë së paku për një pjesë edhe në ato që mori ajo me veti nga vendi dhe populli i vet me përvojë tashmë shekullore të bashkëjetesës me të tjerët, me më shumë besime e etni, me tradita të gjata të vlerësimit dhe të respektit për tjetrin, të ndryshëm dhe të ndryshmen.

Më 1990, kur ne në Kosovë po kalonim kohë të vështira, simbol i bashkëvuajtjes, i dashurisë, i solidaritetit, lauratja e çmimit Nobel për paqe, për vlerat që sublimonte dhe simbolizonte jeta dhe vepra e saj - u zgjodh anëtare nderi e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. Kjo Akademi ndjehet e privilegjuar për këtë fakt, ashtu siç ndjehen shqiptarët krenar dhe të privilegjuar për faktin se kanë pas mundësi t’i japin botës një figurë të shenjtë.

Nëna Tereze u nda prej kësaj bote më 1997, por vlerat e veprës dhe të figurës së saj sa vinin e rriteshin. Në vitin 2003 Nëna Tereze u Lumturua nga papa Gjon Pali i Dytë, i cili po ashtu është një figurë me përmasa krejtësisht të jashtëzakonshme.

E djeshmja ka ikur, e nesërmja s’ka ardhur. Kemi vetëm të sotmen, le të fillojë, thoshte Nënë Tereza. Është një thënie shpesh e cituar, e cila flet vetiu për natyrën e angazhimit të saj. Kjo lidhet me jetën, me ekzistencën e njeriut. Në këtë angazhim për jetën e njeriut, Nënë Tereza tërë shekullin e kaloi në mbrojtje të atyre që i kishte mundur jeta, të të sëmurëve, të të hedhurve nga shoqëria, të leprozve, të skamnorëve. Një humaniste e pashoqe.

Humanizmi i Nënë Terezës, nuk është abstrakt. Gjërat e vogla janë vërtetë të vogla por të besosh në gjërat e vogla është gjë e madhe, thoshte ajo - sepse ato përbëjnë jetën. Vlerat, si solidariteti, humanizmi, synimi i lirisë dhe i paqes, dashuria dhe kërkesa për dinjitet dhe respekt njerëzor kanë mund të hetohen në çdo rast dhe vijimisht me ato që ndodhin në shoqërinë kosovare, megjithë vështirësitë jashtëzakonisht të mëdha që e kishin kapluar vendin. Përtej derdhjes së pashembullt të urrejtjes militare e paramilitare, policore dhe tjetër të Serbisë mbi këtë vend të vogël, vështirësi këto që u superuan me qëndresën e popullit të Kosovës dhe me ndihmën e solidaritetin shumë të çmuar ndërkombëtar dhe megjithë vështirësitë jo të vogla të rindërtimit të vendit, ky popull vazhdon të ushqejë vlera të

solidaritetit, të humanizmit e të bashkëjetesës me fqinjët. Është e sigurt se vlera të tilla synohen në institucionet e dala nga vota e lirë e popullit të cilat - qoftë mbi bazë të besimit të përgjithshëm popullor, të qenies së tij, apo mbi baza morale që përfaqësojnë, simbolika dhe angazhimi njerëzor e rruzullor i lumturuarës Nënë Tereze apo të tjera të ngjashme në këtë frymë pikërisht dinjitetin e njeriut, lirinë e tij dhe të shoqërisë së tij si themel për shoqërinë e ardhshme - e synojnë. Në një litani të Nënë Terezës, lutej për lirinë e njeriut nga frika, mbase nga frika për bjerrjen e dinjitetit.

Jo vetëm për t'u ndërlidhur me idetë madhore të mbrujtura në idetë dhe veprën e Nënë Terezës, edhe me këtë rast më duket e nevojshme të theksohet besimi që ka populli ynë se në lëvizjet e pritshme në raport me faktorin ndërkombëtar dhe me fqinjët liria dhe dinjiteti njerëzor, synimi themelor për raporte barazie sipas masave dhe moralit njerëzor, paqja dhe vlerat e tjera do të mbrohen dhe garantohen. Ky popull beson se ato mund të ruhen dhe mbrohen me pavarësimin e plotë të vendit dhe me respektimin e vullnetit të tij që u është besuar institucioneve të dala nga vota e lirë. Ju faleminderit.

(Duartrokitje)

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACHI:

Profesor ju faleminderit. Dom Lush Gjergji, ju faleminderit. Me kaq Seanca solemne e Kuvendit tonë mori fund. Ju faleminderit për pjesëmarrje.

E transkriptoi: rexhep.tullari@assembly-kosova.org.